



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 1, datë 29.12.2016

PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR,
BASHKIA ELBASAN

Në mbështetje të neneve 7, 20, 25 dhe 58 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671, datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, si dhe të Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Bashkisë Elbasan, si dhe referuar Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 130, datë 07.1.2016, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Elbasan.
2. Plani i Përgjithshëm Vendor përbëhet nga dokumentet si vijon:
 - a) Strategjia Territoriale, shoqëruar me përmbledhjen e Analizës dhe Vlerësimit të Territorit;
 - b) Plani i Zhvillimit të Territorit, shoqëruar me Shtojcën I, sipas përcaktimeve të Rregullores së Planifikimit;
 - c) Rregullorja e Planit;
 - d) Materiali hartografik:
 - i. Vizioni strategjik;
 - ii. Ndarja e territorit në 5 sisteme;
 - iii. Ndarja e territorit në njësi;
 - iv. Përdorimi i propozuar i tokës sipas 14 kategorive bazë;
 - v. Infrastruktura e transportit;
 - vi. Fazat e zbatimit të PPV-së.
3. Autoriteti përgjegjës për miratimin e Planeve të Detajuara për Zonat me Rëndësi Kombëtare është Këshilli Kombëtar i Territorit, me propozim të Ministrit përgjegjës.

4. Gjatë hartimit të Planeve të Detajuara Vendore, projekteve strategjike, projekteve pilot të zhvillimit, si dhe çdo projekti tjetër për zhvillimin e territorit, Bashkia Elbasan duhet të bazohet në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga Plani i Përgjithshëm Vendor.
5. Ngarkohet Bashkia Elbasan për zbatimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në, Ministrinë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjësisë.
6. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohen dokumentet e planifikimit/studimet urbanistike të miratuara më parë nga KRRTRSH/KKT për territorin administrativ të Bashkisë Elbasan, përfshirë si më poshtë:
 - Vendimi Nr. 9, datë 01.09.1993, i KRRTRSH-së, “Për zgjerimin e vijës kufitare të qytetit Elbasan”;
 - Vendimi Nr. 6, datë 19.02.2003, i KRRTRSH-së “Për detyrën e projektimit për studimin urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit dhe vijën kufizuese të kësaj qendre”;
 - Vendimi Nr. 1, datë 18.12.2004, i KRRTRSH-së “Për miratimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit”;
 - Vendimi Nr. 6, datë 07.05.2005 i KRRTRSH-së “Për miratimin e Rregullores për zbatimin e studimit urbanistik të qendrës së qytetit të Elbasanit.”;
 - Vendim Nr. 1, datë 27.12.2005, i KRRTRSH-së “Për miratimin e detyrës së projektimit për Planin e Përgjithshëm Rregullues të qytetit të Elbasanit”;
 - Vendimi Nr. 14, datë 13.01.2009, i KRRTRSH-së “Ndryshim në Studimin Urbanistik të Qendrës së qytetit të Elbasanit dhe Rregullores në zbatim të tij”;
 - Vendimi Nr. 10, datë 21.07.2009, i KRRTRSH-së, “Detyrë Projektimi për Planin e Studimit Urbanistik Pjesor të Kodrës Krasta e Madhe, Elbasan”;
 - Vendimi Nr. 34, datë 10.05.2013, i KKT-së, “Rivlerësimi i studimit urbanistik të qendrës së Elbasanit”.
7. Planet e detajuara vendore dhe lejet e ndërtimit të miratuara në zbatim të dokumenteve të planifikimit të mëparshme, të cilave nuk u ka mbaruar afati i zbatimit, mbeten në fuqi.
8. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENTI

MINISTER I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

